



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1847/6 prot

Datë 04.11.2021

V E N D I M
K.P.P. 857/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Re/Born” SHPK, nga autoriteti kontraktor, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-06338-09-24-2021, me objekt “Certifikimi i Postës Shqiptare sipas ISO 27001” me fond limit 2,400,000.00 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Autoriteti Kontraktor: Postës Shqiptare SHA
Rr. “Reshit Çolloku”, Nr. 4 Tiranë

Ankimues: “Re/Born” SHPK
Njësia Bashkiake nr.9, Rr. “Reshit Petrela”, Zona kadastrale nr.8330, nr.pasurie7/168+1-N17

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-06338-09-24-2021, me objekt “Certifikimi i Postës Shqiptare sipas ISO 27001” me fond limit 2,400,000.00 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

II.2. Në datën 01.10.2021 operatori ekonomik “Re/Born” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Brenda afatit 5 ditor autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të.

II.5. Nëpërmjet shkresës me nr.1964/10 prot., datë 02.11.2021 protokolluar me tonën me nr.1847/5 prot., datë 03.11.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik përgjigjia që autoriteti kontraktor i ka kthyer operatorit ekonomik ankimues në lidhje me ankesën e tij të datës 01.10.2021 për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me shkresën nr. nr.1964/7 prot., datë 2.11.2021 ka vënë në dijeni operatorin ekonomik ankimues dhe Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

Pika 2.3.2.Për kapacitetin teknik: ISHTE:

2.3.2 Operatori Ekonomik të ketë një aktivitet në Shqipëri në fushën e aplikimit të standardeve ndërkombëtare jo më pak se 8 vjet.

Pika 2.3.2 Hiqet

Pretendimi juaj qëndron në lidhje me këtë pikë.

2. Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.3.3 të Dokumentave standarte të tenderit sqarojmë:

Pika 2.3.3.Për kapacitetin teknik: ISHTE:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij staf teknik jo më pak se 7 persona në listpagesat e 3 muajve të fundit , nga të cilët:

a. Të ketë në përbërjen e tij staf teknik (Auditor Lead auditor, jo më pak se 5) me eksperiencë ndërkombëtare në konsulenca apo auditimi mbi standardin ISO 27001 (kontratat dhe CV e personelit).

Pika 2.3.3.Për kapacitetin teknik: BËHET:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij staf teknik jo më pak se 7 persona në listpagesat e 3 muajve të fundit.

Pretendimi juaj qëndron pjesërisht në lidhje me këtë pikë.

3. Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.3.4 të Dokumentave Standarte të tenderit sqarojmë:

Kapaciteti i OVK-së për të ofruar auditim dhe certifikim për ISO 27001 është vlerësuar në fazën e akreditimit. OVK-të mund të zgjedhin lirshëm tregun se ku duan të veprojnë.

POSTA SHQIPTARE është shoqëri aksionare dhe pronësia private apo shtetërore nuk ka asnjë ndikim në mënyrën e auditimit dhe certifikimit sipas ISO 27001.

Pika 2.3.4. Për kapacitetin teknik: ISHTE

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë eksperiencë në konsulenca dhe auditime për ISO 27001 si në Shqipëri edhe në Vende të komunitetit European (kontrata me kompanite kliente)

Pika 2.3.4 HIQET

4. Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.3.5 të Dokumentave Standarte të tenderit sqarojmë:

Pika 2.3.5. Për kapacitetin teknik: ISHTE

2.3.5 Konsulentët ose auditorët e Operatorit Ekonomik të kenë eksperiencë në auditimin e kompanive të ngjashme si dhe të kompanive shtetërore.

Pika 2.3.5. Për kapacitetin teknik: HIQET

Pretendimi juaj qëndron në lidhje me këtë pikë.”

II.6. KPP vëren se në shtojcën e publikuar në sistem autoriteti kontraktor ka kryer modifikime edhe në lidhje me shtojcën 5 të DST sipas pretendimeve të operatorit ekonomik të shprehura në ankesë si “kundërshtime shtesë” duke përmbushur edhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë pikë.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me shkresën nr. nr.1964/7 prot., datë 2.11.2021 ka vënë në dijeni operatorin ekonomik ankimues dhe Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

Pika 2.3.2.Për kapacitetin teknik: ISHTE:

2.3.2 Operatori Ekonomik të ketë një aktivitet në Shqipëri në fushën e aplikimit të standardeve ndërkombëtare jo më pak se 8 vjet.

Pika 2.3.2 Hiqet

Pretendimi juaj qëndron në lidhje me këtë pikë.

2. Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.3.3 të Dokumentave standarte të tenderit sqarojmë:

Pika 2.3.3.Për kapacitetin teknik: ISHTE:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij staf teknik jo më pak se 7 persona në listpagesat e 3 muajve të fundit , nga të cilët:

a. Të ketë në përbërjen e tij staf teknik (Auditor Lead auditor, jo më pak se 5) me eksperiencë ndërkombëtare në konsulenca apo auditimi mbi standardin ISO 27001 (kontratat dhe CV e personelit).

Pika 2.3.3.Për kapacitetin teknik: BËHET:

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij staf teknik jo më pak se 7 persona në listpagesat e 3 muajve të fundit.

Pretendimi juaj qëndron pjesërisht në lidhje me këtë pikë.

3. Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.3.4 të Dokumentave Standarte të tenderit sqarojmë:

Kapaciteti i OVK-së për të ofruar auditim dhe certifikim për ISO 27001 është vlerësuar në fazën e akreditimit. OVK-të mund të zgjedhin lirshëm tregun se ku duan të veprojnë.

POSTA SHQIPTARE është shoqëri aksionare dhe pronësia private apo shtetërore nuk ka asnjë ndikim në mënyrën e auditimit dhe certifikimit sipas ISO 27001.

Pika 2.3.4. Për kapacitetin teknik: ISHTE

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë eksperiencë në konsulenca dhe auditime për ISO 27001 si në Shqipëri edhe në Vende të komunitetit European (kontrata me kompanite kliente)

Pika 2.3.4 HIQET

4. Në lidhje me pretendimin tuaj për pikën 2.3.5 të Dokumentave Standarte të tenderit sqarojmë:

Pika 2.3.5. Për kapacitetin teknik: ISHTE

2.3.5 Konsulentët ose auditorët e Operatorit Ekonomik të kenë eksperiencë në auditimin e kompanive të ngjashme si dhe të kompanive shtetërore.

Pika 2.3.5. Për kapacitetin teknik: *HIQET*

Pretendimi juaj qëndron në lidhje me këtë pikë.”

III.1.2 KPP vëren se në shtojcën e publikuar në sistem autoriteti kontraktor ka kryer modifikime edhe në lidhje me shtojcën 5 të DST sipas pretendimeve të operatorit ekonomik të shprehura në ankesë si “kundërshtime shtesë” duke përmbushur edhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimes në lidhje me këtë pikë.

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”. Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-06338-09-24-2021, me objekt “Certifikimi i Postës Shqiptare sipas ISO 27001” me fond limit 2,400,000.00 lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 11.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro